



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGETARE

URDHER

Nr. ⁸⁹⁹~~877~~ Date 4.12.2007

PËR DEPOZITIMIN E STATUTIT TË
SH.A. "UJËSJELLËS" GJIROKASTER QYTET

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1. Depozitimn e statutit te ndryshuar te shoqërisë Sh.A. " Ujësjiellës " Gjirrokaster Qytet.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTRI

GENORALI

Iskender Ali Aliu

Adresa: Blvd "Dëshmorët e Kombit" Nr.2
Llogarit: gjendje@me.gov.al
Internet: <http://www.mte.gov.al>

Tel: +355 4 226467
Tel: +355 4 223158
Fax: +355 4 234052

MIRATOHET

NR. 899/11 PROT. DATE 4/12/2007

MINISTRI

GENJRALI

STATUT I SHOQËRISË ANONIME " UJËSJELLËS " GJIROKASTËR QYTET

**Neni 1
Emërtimi**

Shoqëria emërtohet Sh.A. "Ujësjiellës " Gjirokastrë Qytet. Emërtimi i shoqërisë mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.

**Neni 2
Selia**

Selia e shoqërisë është në Gjirokastrë. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

Neni 3

Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjisllacioni në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

**Neni 4
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e kompanisë është pa afat të caktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të asamblesë së aksionarëve.

**Neni 5
Objekti**

Objekti i shoqërisë është:

- 1.Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
 - 2.Mirëmbajtjen e sistemit(eve) të furnizimit me ujë të pijshëm;
 - 3.Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
 - 4.Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe shitja e tij;
 - 5.Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.
- Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi. Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe

Iskender Dili Aliu

miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.

Neni 6 Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është 128.000.000 lekë dhe është i ndarë në 128.000 aksione me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë secili. Kapitali i shoqërisë është derdhur dhe nënshkruar tërësisht.

Neni 7 Aksionet

1. Aksionet janë të formës nominative dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit apo titullarëve në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë apo ndërmjetësve financiarë.
3. Aksionet zotërohen në masën 100% nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës si përfaqësuese e pronarit shtet.

Neni 8 Asambleja e aksionarëve

Asambleja e aksionarëve, e zakonshmja dhe e jashtëzakonshmja, mbledhet në selinë e shoqërisë. Ajo thirret nga Këshilli Mbikëqyrës apo Drejtori i Përgjithshëm. Në mungesë ajo mund të thirret gjithashtu nga: a) eksperti kontabël i autorizuar, b) nga një mandatmbajtës, i caktuar nga gjyqi, me kërkesën e çdo personi të autorizuar për një rast urgjent, ose c) nga likuiduesi si dhe me kërkesë të aksionarëve që zotërojnë të paktën 10% të aksioneve të shoqërisë.

Neni 9 Kompetencat e asamblesë së zakonshme

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim, përveç atyre që në bazë të ligjit apo këtij statuti duhen marrë nga asambleja e jashtëzakonshme. Asambleja e zakonshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar. Ajo merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm në qoftë se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë së bashku të paktën 1/2 e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se kjo mbledhje nuk realizohet, në të dytën duhet të marrin pjesë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar, që zotërojnë së bashku të paktën 1/4 të aksioneve me të drejtë vote. Asambleja e zakonshme merr vendimin me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

Jashmari Doli Aure

Neni 10

Kompetencat e asamblesë së jashtëzakonshme

Vetëm asambleja e jashtëzakonshme ka kompetenca të ndryshojë statutin me të gjitha dispozitat e tij. Çdo klauzolë e kundërt konsiderohet e pavlefshme.

Asambleja e jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhjen e parë zotërojnë së bashku të paktën 2/3 e aksioneve. Në mungesë të këtij kuorumi mbledhja e dytë e asamblesë thirret në një datë të mëvonshme, jo më larg se dy muaj nga data e thirrjes së parë, dhe mund të marrë vendime të vlefshme në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhjen e dytë zotërojnë jo më pak se 1/2 e aksioneve me të drejtë vote.

Asambleja e jashtëzakonshme merr vendim me një shumicë votash prej 4/5 (80%) e votave që u përkasin aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 11

Kryetari dhe sekretari i asamblesë së aksionarëve

Asambleja e aksionarëve drejtohet nga kryetari i Këshillit Mbikëqyrës apo në mungesë të tij nga një person i autorizuar nga kryetari.

Kryetari i asamblesë asistohet nga një sekretar i emëruar nga asambleja e aksionarëve.

Proces verbal i çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e asamblesë tregon datën dhe vendin e mbledhjes, mënyrën e thirrjes, rendin e ditës, emrat e drejtuesit dhe sekretarit të asamblesë, kuorumi i arritur dhe numrin e aksioneve me të cilat është votuar, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e asamblesë, një përmbledhje të diskutimeve, tekstin e vendimeve të kaluara për votim dhe rezultatin e votimit. Procesverbal i firmoset nga kryetari dhe sekretari i asamblesë dhe duhet noterizuar nga një noter i pranishëm në mbledhjen e asamblesë.

Neni 12

Thirrja e asamblesë së aksionarëve

Thirrja e mbledhjeve të asamblesë së aksionarëve bëhet nëpërmjet lajmërimit që botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore.

Në rast se të gjitha aksionet janë nominative apo në rast se shoqëria ka një aksionar të vetëm, përveç botimeve të parashikuara në paragrafin e mësipërm duhet të dërgohet dhe një njoftim i dërguar me letër rekomande në adresën e çdo aksionari me shpenzimet e shoqërisë.

Njoftimi, që duhet të bjerë në dorën e aksionarëve apo të njihet prej tyre të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së asamblesë, përcakton datën, orën dhe vendin ku bëhet mbledhja, natyrën e mbledhjes, të zakonshme apo të jashtëzakonshme dhe rendin e ditës. Në rast nevojë, ai tregon vendin ku duhet të depozitohen aksionet për prurësin ose certifikata e depozitimit të këtyre aksioneve, për të lejuar të drejtën e pjesëmarrjes në asamble dhe afatin e fundit të këtij depozitimi.

Çdo mbledhje asambleje që thirret në mënyrë të parregullt duhet të anulohet.

Megjithatë, kur të gjithë aksionarët janë prezentë apo të përfaqësuar ligjërisht, veprimi i anulimit nuk pranohet.

Legjislacioni i referimit për mënyrën dhe formën e njoftimit të aksionarëve dhe të zhvillimit të mbledhjes së asamblesë është ligji shqiptar për shoqëritë tregtare.

Jashmer Doli

Neni 13

Dendi i ditës së asamblesë së aksionarëve

Rendi i ditës i mbledhjeve të asamblesë së aksionarëve përcaktohet nga autori i lajmërimit. Megjithatë një apo disa aksionarë që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit, u njihet e drejta për të futur në rendin e ditës disa projektrezoluta.

Këto projektrezoluta dërgohen në selinë e shoqërisë të shoqëruara me shkresë përcjellëse dhe me dokumentin ku vërtetohet zotërimi apo përfaqësimi i pjesës së kapitalit të kërkuar sipas paragrafit të dytë të këtij neni.

Asambleja nuk mund të shqyrtojë një çështje që nuk përcaktohet në rendin e ditës, megjithatë ajo mund të shkarkojë një ose disa anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe të procedojë për zëvendësimin e tyre në çdo rrethanë sipas parashikimeve të neneve 15 deri 18 të këtij statuti. Në rast se mbledhja e parë e asamblesë nuk realizohet, rendi i ditës i mbledhjes së asamblesë nuk mund të ndryshohet në lajmërimin për mbledhjen e dytë.

Neni 14

Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të Sh.A. "Ujësjetllës" Gjirrokastër Qytet janë:

1. Këshilli Mbikëqyrës
2. Drejtori i Përgjithshëm

Neni 15

Këshilli Mbikëqyrës

Përveç rasteve të parashikuara në pikën 1 të vendimit nr. 642, datë 11.10.2007 të Këshillit të Ministrave "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore", të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 anëtarë, të cilët emërohen nga asambleja e zakonshme e aksionarëve.

Nëse një aksionar i vetëm zotëron më shumë se 1/2 e aksioneve të shoqërisë, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen si më poshtë:

- Aksionari që zotëron më shumë se 1/2 e aksioneve të shoqërisë zgjedh 50+1 të numrit të anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës.

- Anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen nga aksionarët e tjerë.

Nëse aksionarët që zotërojnë më pak se 1/2 e aksioneve të shoqërisë nuk arrijnë të bien në konsensus për të zgjedhur anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, emërimi i këtyre të fundit bëhet si më poshtë:

- Aksionari që zotëron më shumë aksione pas atij (aksionarit) që zotëron më shumë se 1/2 e aksioneve të shoqërisë, cakton 1 anëtar të Këshillit Mbikëqyrës.

- Anëtarët e tjerë përcaktohen për një periudhë 1-vjeçare me rotacion. Në këtë rast vendimi i asamblesë përcakton ditën e fillimit dhe mbarimit të mandatit të aksionarit/ëve të emëruar, sipas kësaj pike dhe aksionarin që ka të drejtë të përcaktojë anëtarin e Këshillit Mbikëqyrës.

Me mbarimin e këtij afati, aksionari, që ka të drejtën e caktimit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, nëse nuk e ka përcaktuar emrin e tij në mbledhjen e asamblesë, i dërgon Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë, si dhe organeve përkatëse që mbajnë regjistrin tregtar njoftim me emrin e anëtarit që do të caktohet në Këshillin Mbikëqyrës.

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, njofton aksionarin që ka të drejtën e caktimit të anëtarit të

Isahmic Qeli Qeli

Këshilli Mbikëqyrës, 1 muaj përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të caktuar me rotacion.

Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me këtë nen, është i pavlefshëm.

Neni 16
Kohëzgjatja e mandatit të Këshillit Mbikëqyrës

1. Kohëzgjatja e mandatit të Këshillit Mbikëqyrës është 3 vjet. Ata mund të rizgjidhen pa kufizim.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë persona fizikë. Ata duhet:
 - Të kenë të paktën eksperiencë jo më pak se 8 vjet në degë të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë;
 - Të jenë me profesion inxhinier, ekonomist, jurist, dhe mundësisht me formim pasuniversitar;
 - Të njohin minimumi një gjuhë të huaj.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të zgjedhur nga asambleja mund të shkarkohen në çdo moment nga kjo e fundit për shkaqe të përligjura. Pavarësisht parashikimeve të kësaj pike, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, të përcaktuar nga aksionarët që zotërojnë më pak se 1/2 e aksioneve të shoqërisë, nuk mund të shkarkohen pa propozimin e këtyre aksionarëve.

Neni 17
Zëvendësimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

1. Në rastin e vendeve bosh, që krijohen nga vdekja apo dorëheqja e një apo disa anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ky këshill mundet, për periudhën midis dy mbledhjeve të asamblesë, të bëjë emërimet të përkohshme duke pasur parasysh parashikimet e nenit 15 të statutit.
2. Kur numri i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ka zbritur nën minimumin ligjor, Drejtori i Përgjithshëm duhet të thërrasë urgjentisht mbledhjen e zakonshme të asamblesë për të plotësuar numrin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
3. Emërimet e bëra nga Këshilli Mbikëqyrës, në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, i nënshtrohen ratifikimit në mbledhjen e radhës të asamblesë së zakonshme. Në mungesë të ratifikimit, shqyrtimet e bëra dhe vendimet e marra më parë nga Këshilli Mbikëqyrës mbeten gjithmonë të vlefshme.
4. Nëse një ose disa vende të Këshillit Mbikëqyrës mbeten bosh për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqje të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, zëvendësimi i tyre duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga koha në të cilën vendi ka mbetur bosh.
5. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës i emëruar në zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit.

Neni 18
Kufizimi i mandateve

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Sh.A. "Ujësjetllës" Gjirokastrë Qytet, të emëruar nga asambleja e aksionarëve, nuk mund të jenë të punësuar në këtë shoqëri. Asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të bëjë pjesë në më shumë se 2 (dy) Këshilla Mbikëqyrës të shoqërive anonime që kanë seli në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Jashmir Deli

Neni 19
Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre në Këshillin Mbikëqyrës dhe mund të jenë të rizgjedhshëm.
2. Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton këtij dhe pagën.
3. Në rast mungese ose pengimi të kryetarit, mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës drejtohet nga

Neni 20

Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet jo më pak se njëherë në tre muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë anonime, me thirrjen e kryetarit ose, në mungesë të tij, të zëvendëskryetarit.
2. Kryetari, dhe në mungesë të tij zëvendëskryetari, duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data kur Drejtori i Përgjithshëm ose 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.
3. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkuar mund të thërrasin Këshillin Mbikëqyrës duke i përcaktuar rendin e ditës.
4. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë, telegram, fax ose telex.
5. Çdo thirrje për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës.
6. Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje.
7. Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm, në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se 5 anëtarë të tij.
8. Këshilli Mbikëqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e këshillit të pranishëm në atë mbledhje.
9. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës pasqyrohen në procesverbalet e mbajtura gjatë mbledhjes nga sekretari i Këshillit Mbikëqyrës në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.
10. Kopje të këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari (ose në mungesë të tij zëvendëskryetari) dhe sekretari.

Neni 21

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës emëron dhe shkarkon Drejtorin e Përgjithshëm të shoqërisë, kur për këtë bien dakord/votojnë pro 5 anëtarë të tij.
2. Këshilli Mbikëqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë nga drejtorja dhe i jep kësaj të fundit autorizimin për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryhen nga drejtorja pa autorizimin e Këshillit Mbikëqyrës.
3. Me emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm Këshilli Mbikëqyrës lidh kontratë me të për

detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë.

4. Këshilli Mbikëqyrës autorizon Drejtorin e Përgjithshëm që të kryejë veprimet dhe të realizojë marrëveshjet e parashikuara në nenet 23 dhe 24 të statutit.
5. Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.
6. Drejtori i Përgjithshëm i paraqet raport Këshillit Mbikëqyrës të paktën njëherë në tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i paraqesë Këshillit Mbikëqyrës llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli. Këshilli Mbikëqyrës i propozon Asamblesë së ortakëve lidhur me këto çështje:
a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe

Yashmiri Oeli Adu

afatgjatë të shoqërisë.

- b) Treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, si element bazë i vlerësimit të punës së drejtorisë së shoqërisë.
- c) Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.
- d) Hapjen e veprimtarive ose njësive të reja dhe ndryshimin e objektit të shoqërisë.
- e) Shtitjen e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërive sipas legjislacionit në fuqi.
- f) Krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera.
- g) Marrjen e huave afatmesme, afatgjata.
- h) Si dhe për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare" është kompetencë e asamblesë së përgjithshme.

Neni 22

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës do të caktohet nga asambleja e aksionarëve, sipas dispozitave përkatëse ligjore apo nënligjore dhe mbulohej nga shoqëria. Shoqëria njih gjilhashtu dhe shpenzimet e bëra nga anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, kur këta të fundit dërgohen me shërbim nga vetë Këshilli Mbikëqyrës për probleme të kompanisë.

Neni 23

Drejtori i Përgjithshëm

1. Shoqëria administrohet nga Drejtori i Përgjithshëm.
2. Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë, që brenda kompetencave të tij t'u japë një ose disa punonjësve të kompanisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh, me të drejtën e nëndelegimit.
3. Drejtori i Përgjithshëm është person fizik, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Për t'u zgjedhur Drejtor i Përgjithshëm, personi duhet të plotësojë kushtet e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 19.08.1999. Ai mund të zgjidhet edhe jashtë të punësuarve në shoqëri. Nëse një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës emërohet Drejtor i Përgjithshëm, mandati i tij në Këshillin Mbikëqyrës përfundon. Një person nuk mund të emërohet Drejtor i Përgjithshëm në më shumë se një shoqëri. Ai nuk mund të jetë mbi moshën 65 vjeç.
4. Drejtori i Përgjithshëm mund të shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës për shkaqe të përligjura. Drejtori i Përgjithshëm emërohet për një periudhë kohe prej 4 (katër) vjetësh, por

mbi baza kontratash të rinovueshme vjetore. Drejtori i Përgjithshëm mund të rimërohet.

5. Paga e Drejtorit të Përgjithshëm caktohet nga Këshilli Mbikëqyrës në aktin e emërimit të tij.
6. Drejtori i Përgjithshëm ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë.
7. Në marrëdhëniet me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e nënshkruara nga Drejtori i Përgjithshëm edhe kur këto akte e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rasis kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i Drejtorit të Përgjithshëm kapërcen objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është provë e njaltueshme. Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm duhet të respektohen nga të tretët.

8. Aktet, me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të nënshkruhen nga Drejtori i Përgjithshëm ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.

9. Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet apo me vlerë mbi 2 (dy) milion lekë bëhet me

Dashmori Dori Dori

autorizim të Këshillit Mbikëqyrës, në rastet emergjente dhe pamundësi për të marrë autorizim nga Këshilli Mbikëqyrës, për kontrata që i kalojnë limitet e mësipërme duhet marrë miratimi me shkrim i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe në mungesë të tij zëvendëskryetarit. Këta të fundit njoftojnë në mbledhjen e parë të Këshillit Mbikëqyrës, këtë të fundit, për autorizimin e dhënë.

10. Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore që miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

11. Drejtori i Përgjithshëm bën strukturën e organizimit të shoqërisë të cilën e miraton Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 24

Marrëveshjet që kërkojnë autorizim paraprak të Këshillit Mbikëqyrës

Marrëveshjet që kërkojnë autorizim paraprak të Këshillit Mbikëqyrës janë:

1. Të gjitha marrëveshjet që bëhen ndërmjet shoqërisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm apo ndonjë anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë;
2. Marrëveshjet, me të cilat një nga personat e sipërpërmendur lidhet indirekt, apo në të cilat ai lidhet me shoqërinë nëpërmjet një personi ndërmjetës;
3. Marrëveshjet që veprojnë ndërmjet shoqërisë dhe një subjekti tjetër ekonomik të një lloji të çfarëdoshëm, në rast se Drejtori i Përgjithshëm apo një nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë është pronar, ortak "i pakufizuar", administrator apo anëtar i drejtorisë së subjektit tjetër ekonomik.

Neni 25

Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Aksionerëve dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Neni 26

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 27

Inventari-llogaritë vjetore

1. Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe veprimtarisë së saj, në pajtim me kërkesat ligjore.
2. Në mbylljen e ushtrimit financiar, Drejtori i Përgjithshëm harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar.
3. Drejtori i Përgjithshëm përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar.

Neni 28

Rezultati i ushtrimit dhe përcaktimi i fitimit

1. Rezultati i veprimtarisë përcaktohet nga diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, pas zbritjes së amortizimeve dhe provizioneve.
2. Nga fitimet e ushtrimit, pasi të jenë zbritur, kur është rasti humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5 (pesë) % për të krijuar fondet e rezervës së detyrueshme.

Jashmer Dili Aliu

- (një të dhjetën) e kapitalit themeltar nuk bëhen më heqje nga fitimet e ushimit.
3. Ajo (heqja) rifillon, kur për një arsye të çfarëdoshme, rezerva e domosdoshme ka zbritur në 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar.
4. Përdorimi i fitimit bëhet me vendim të asamblesë së aksionarëve.

Neni 29

Likuidimi i shoqërisë

Likuidimi i shoqërisë do të bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

Neni 30

Dispozita të përgjithshme

Për çfarë nuk është shprehur në statut, referimi bëhet te dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi për shoqëritë tregtare.

Dashmire Dini



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E SHERBIMEVE JURIDIKE

Tiranë, më 5/12/2007

Nr. 899/... Prot.

2

A U T O R I Z I M

Në mbështetje të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë", Titulli II. Kreu I (përfaqësimi), autorizoj Znj. Mimoza Kita me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, të përfaqësojë Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për depozitimin e Urdhërit të Ministrit Nr. 899, dt. 04.12.2007 "Për depozitimin e statutit të Sh.A "Ujësjetës" Gjirokaster Qytet, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Të autorizuarës i jap të drejtat që lejon ligji për të përfaqësuar këtë institucion me këto tagra:

Të bëjë kërkesa, ankim si dhe të nënshkruajë ato, si dhe të tërheqë ekstraktet.

Të gjitha qëndrimet e veprimet e kryera nga e autorizuar në emër të këtij institucioni i konsideroj të drejta e të mirëqena.

MINISTRI

GENORILI



Jashmire Delli Qeser

URDHER REGJISTRIMI

30474

I	Nr. Regjistrimi
II	A. Emri <i>Uje Gjellit Komali Zime, R.A.</i> B. Selia <i>Gjironkëstër.</i> C. Objekti <i>Prodhimi. Është njësi me të përzier për popullsi, lëndë kulturale, shërbime private marrëdhënie dhe të ndërmarrës.</i> Ç. Kapitali <i>128000000 Lëlle M.E 100 %</i>
III	Administrator <i>Daskamir Zyberq.</i> <i>(M. L. C. Statutari)</i> Drejtor.
IV	Kohëgjatja — Akt-Themelimi <i>1 fope</i> Statuti <i>5 fope.</i>
V	Nenshkrimi — <i>Urdhër M.E Nr 32 dat 11/10/03</i> Statuti <i>Dt. 30/10/03</i> Akt-Themelimi

GJYQTARE

*M. Dedi
M. Dedi*

*— Raport i detyrues kontable
i detyrues dat 7/7/03
(9 fope!)*

AKT-THEMELIMI

I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 1.10.2003, ne baze te nenit 1 te Ligjit nr.8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne Ligjin nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me ligjet perkatese, Ministri i Ekonomise, me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise,

V E N D O S I:

- 1- Te krijoje Shoqerine Anonime "Ujesjelles Kanalizime Qytet" Sh.a. Gjirokaster me kapital 100% shteteror.
- 2- Objekti i Shoqerise eshte:
Prodhim dhe shitje uje te pijshem per popullaten, entet shteterore, subjektet private qe veprojne ne qytetin e Gjirokastres si dhe mirembajtjen e rrjetit te kanalizimeve te ujrave te zeza per kete qytet.
- 3- Shoqeria do te kete seline e saj ne Gjirokaster dhe ajo mund te çele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
- 4- Kapitali themeltar eshte 128,000,000 leke ndare ne 128,000 aksione me vlere nominale 1,000 leke secili.
- 5- Shoqeria ka nje zgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
- 6- Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga:
Z. Bujar Reme
Z. Dashamir Sejdo
Z. Thoma Rrushaj
- 7- Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i Shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
- 8- Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.



STATUTI I SHOQËRISË ANONIME

NENI 1 Emertimi dhe selia

Shoqeria Anonime krijohet nga transformimi i ndermarrjes Shtetërore "Ujesjelles Kanalizime Qytet" Gjirrokaster. Shoqeria e krijuar në këtë mënyrë emërohet: "Ujesjelles Kanalizime Qytet" sh.a.Gjirrokaster. Selia e Shoqërisë është në adresë: Gjirrokaster.

NENI 2 Objekti i Shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

Prodhim dhe shitje uje të pijshëm për popullatën, entet shtetërore, subjektet private që veprojnë në qytetin e Gjirrokastres si dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza për këtë qytet. Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të reja dhe krijimin e shoqërive të reja, si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera jashtë vendit.

NENI 3 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 128,000,000 leke. Numri i aksioneve është 128,000. Vlera nominale e aksionit është 1,000 leke. Në kapitalin themeltar është përfshirë vlera e truallit prej 2,069,255 leke, vlerësuar nga Pushteti Lokal Gjirrokaster në mbështetje të V.K.M nr.169, datë 13.03.2003.

NENI 4 Transferimi i aksioneve në rast privatizimi.

Transferimi i aksioneve në rast privatizimi do të kryhet me Urdhër të Ministrit të Ekonomisë, në bazë të legjislacionit në fuqi për privatizimin.


NENI 5 Organet drejtuese të Shoqërisë

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- 1) Këshilli Mbikqyres
- 2) Drejtoria

NENI 6 Këshilli Mbikqyres

- Këshilli Mbikqyres përbehet nga 3 (tre) anëtarë. Anëtarët e keshillit mbikqyres emërohen nga Ministri i Ekonomisë.



- Kohezgjatja e funksionit të tyre është 4 (kater) vjet. Antaret e keshillit mbikqyres janë të gjithë të rizgjedhshëm. Ata mund të revokohen nga titullari i organit që i ka emëruar për shkak të perligjura.
- Antaret e keshillit mbikqyres janë persona fizike. Ata nuk mund të jenë të punësuar në Shoqëri.
- Nëse një, ose disa vende të antareve të keshillit mbikqyres mbeten bosh për shkak të vdekje, shkarkimi ose dorëheqje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj. Antari i/e keshillit mbikqyres i emëruar me zëvendësimin të një antari tjetër, perfundon mandatin e paraardhësit.
- Antaret e keshillit mbikqyres të moshës 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç nuk mund të jenë më shumë se 1/3 (një e treta) e numrit të përgjithshëm të keshillit mbikqyres. Nëse ky raport tejkalohet antari më i moshuar do të konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

NENI 7

Kryetari dhe zëvendës kryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli Mbikqyres zgjedh ndërmjet antareve të tij një kryetar dhe një zëvendës kryetar, të cilët thërresin mbledhjen e keshillit dhe të drejtojnë diskutimet. Ata zgjidhen për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm.

Keshilli Mbikqyres mund të ngarkojë një person si sekretar edhe jashtë antareve të tij. Në rast mungese ose pengimi të kryetarit, mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga zëvendëskryetari.

NENI 8

Vendimet e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres mbledhet sa herë e kërkon interesi i shoqërise, me thirrjen e kryetarit, ose në mungese të tij të zëvendëskryetarit. Kryetari duhet të thërresë mbledhjen e keshillit mbikqyres brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kur drejtoria ose 1/3 (një e treta) e antareve të keshillit mbikqyres i paraqitin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje atëherë antaret duhet të thërresin mbledhjen e keshillit mbikqyres, duke përcaktuar rendin e ditës. Në parim thirrja duhet të bëhet 3 (tre) ditë përpara, me leter, telegram, teleks ose fax. Por thirrja mund të jetë e vlefshme edhe me gojë dhe pa afat nëse antaret e keshillit mbikqyres do ta pranojnë atë.

Cdo thirrje duhet të përcaktojë rendin e ditës.

Mbledhja e keshillit mbikqyres zhvillohet në selinë e Shoqërise ose në cdo vend tjetër të përcaktuar në thirrje. Keshilli mbikqyres mund të marrë një vendim të vlefshëm vetëm nëse janë të pranishëm jo më pak se gjysma e antareve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të antareve të pranishëm, në rast barazimi votash, ajo e kryetarit është përcaktuese.

Keshilli mbikqyres mban një regjister të pjesëmarrjes në mbledhjen e tij i cili nënshkruhet nga antaret e pranishëm në mbledhje. Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, nga kryetari ose zëvendës kryetari.

Kopjet e vendimeve vertetohen nga kryetari ose zëvendëskryetari i keshillit mbikqyres.

NENI 9

Kompetencat e keshillit mbikqyres

- Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërise nga drejtoria dhe i jep kësaj të fundit autorizimin për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryhen nga drejtoria pa autorizimin e keshillit mbikqyres.
- Keshilli Mbikqyres emëron drejtorinë. Keshilli cakton njerin prej antareve të drejtorisë me cilesinë e drejtorit.
- Me emërimin e antareve të drejtorisë, keshilli mbikqyres lidh kontratë me ta për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërise.
- Keshilli Mbikqyres autorizon drejtorinë që të kryejë veprimet dhe të realizojë marrëveshjet e parashikuara në nenet 12 dhe 13 të këtij statuti.
- Keshilli Mbikqyres ka të drejtë të kryejë në cdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i cmon të

pershtatshme dhe te njihet me dokumentacionin qe i gjykon te nevojshem per permbushjen e detyres se tij.

- Drejtoria i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar drejtoria duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli.
- Keshilli Mbikqyres i propozon Ministrit te Ekonomise lidhur me keto ceshtje:
 - a) Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afat mesem dhe afat gjate te Shoqerise.
 - b) Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te Shoqerise.
 - c) Hapja e veprimtarive ose njesive te reja dhe ndryshimin e objektit te Shoqerise.
 - d) Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te Shoqerise.
 - e) Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesemarrjen ne kapitalin e Shoqerive te tjera
 - f) Marrjen e huave afatmesme dhe afatgjate.
 - g) Si dhe cdo gje tjeter qe ne baze te Ligjit "Per shoqerite tregtare" eshte kompetence e Asamblese se Pergjithshme.

NENI 10

Shperblimi i antareve te keshillit mbikqyres

Shperblimi i antareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara ne Vendim te Keshillit te Ministrave.

NENI 11

Drejtoria

- Shoqeria administrohet nga drejtoria, e cila mund te perbehet nga nje ose disa antare. Numri i antareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres me nje vendim te tij.
- Drejtoria emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakort jo me pak se 2/3 (dy te tretat) e te gjithe antareve te ketij keshilli.

Antaret e drejtorise jane persona fizike, ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshem. Ata mund te zgjidhen dhe jashte te punesuarve ne Shoqeri.

Nese nje antar i keshillit mbikqyres emerohet antar i drejtorise mandati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet antar i drejtorise ose drejtor ne me shume se nje Shoqeri. Antaret e drejtorise mund te emerohen nga keshilli mbikqyres per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga funksioni i antarit te drejtorise nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates.

- Antaret e drejtorise emerohen per nje periudhe kohe 4 (kater) vjecare. Ne rastet e pushimeve dhe mungesave te zgjatura keshilli mbikqyres ben zevendesimin e tyre.
- Antaret e drejtorise jane te riemerueshem, ata nuk mund te jene mbi moshen 65 vjec. Antari i drejtorise qe mbush moshen 65 vjec konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.
- Paga e antareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tyre.

NENI 12

Kompetencat e drejtorise.

- Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te drejtorise.
- Ne marredheniet me te tretet Shoqeria merr persiper detyrime qe rrjedhin nga aktet e drejtorise te nenshkruar nga antari me cilesine e drejtorit edhe kur keto e tejkalojne objektin veprimtarise se Shoqerise, pervec rastit kur Shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorise

kapercenat objektin e veprimtarise se Shoqerise dhe vepronte me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt, duke patur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

- Akte me te cilat Shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve duhet te nenshkruhen nga antari me cilesine e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte.
- Drejtoria merr vendim me shumice te thjeshte votash te antareve te pranishem kur jane prezent jo me pak se gjysma e antareve te saj. Ne rast barazimi votash, vota e antarit te caktuar me cilesine e drejtorit eshte percaktuese.
- Lidhja e kontratave me a fat mbi 2 (dy) vjet dhe me vlere mbi 2 (dy) milion leke behet me autorizim te keshillit mbikqyres.
- Marredheniet brenda Shoqerise percaktohen me rregullore qe miratohet nga keshilli mbikqyres.
- Drejtoria ben strukturen e organizimit te shoqerise, te cilen e miraton keshilli mbikqyres.

NENI 13

Marreveshjet ndermjet Shoqerise dhe drejtorise ose te nje antari te keshillit mbikqyres

Cdo marreveshje ndermjet Shoqerise dhe antareve te drejtorise ose nje antari te keshillit mbikqyres qofte e drejtperdrejte ose jo e drejtperdrejte duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres. Percaktimi i mesiperem eshte i vlefshem edhe per marreveshjet ndermjet Shoqerise dhe nje Shoqerie tjeter, kur nje antar i keshillit mbikqyres eshte dhe antar i keshillit mbikqyres te nje Shoqerie tjeter, me te cilen propozohet te lidhet marreveshja. Kjo nuk eshte e zbatueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimtarine rrjedhese te Shoqerise qe kryhen ne kushte normale. Antari i drejtorise ose i keshillit mbikqyres i interesuar duhet te njoftoje keshillin mbikqyres per nje marreveshje per te cilen zbatohet kerkesa e ketij neni te statutit. Antari i ineresuar i keshillit mbikqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

NENI 14

Eksperti kontabel i autorizuar

Kontrolli i Shoqerise ushtrohet nga 1 (nje) ekspert kontabel i autorizuar i cili emerohet nga aksionmbajtesi i vetem dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

NENI 15

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga date e regjistrimit ne regjistrin tregtar deri me date 31 dhjetor.

NENI 16

Inventari-llogarite vjetore

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbyllje te ushtrimit drejtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar. Drejtoria pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e Shoqerise gjate ushtrimit financiar.

NENI 17

Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i fitimit.

Rezultati i ushtrimit percaktohet si difference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem. Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5% (pese perqind) per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte e detyrueshme, kur kjo rezerve arrin ne 1/10 (nje te dhjeten) e

e kapitalit themeltar. Ajo rifillon per nje aresye cfaredo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nen ne 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit.
Perdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me urdher te Ministrit te Ekonomise.

NENI 18

Emerimi i antareve te pare te keshillit mbikqyres.

Si antare te pare te keshillit mbikqyres:

Z. Bujar Reme
Z. Thoma Rrushaj
Z. Dashamir Sejdo

NENI 19

Emerimi i ekspertit kontabel te pare te autorizuar

Eksperti i (te) pare i (te) autorizuar emerohet (n) :

Z. Luan Muça

NENI 20

Asambleja e pergjithshme

Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga ligji n.7638 date 19.11.92 "Per shoqerite tregtare" qe nuk jane shprehur ne kete statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomise me cilesine e aksionerit te vetem.

NENI 21

Dispozita te fundit

Ne nje afat prej 6 (gjashte) muajsh nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar drejtori i Shoqerise do te jete drejtor ish ndermarrjes shteterore.
Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet nga Ministri i Ekonomise vec per shkaqe te perligjura.

NENI 22

Per cfare nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per Shoqerite tregtare.



**STATUT I SHOQËRISË AKSIONARE UJESJELLES KANALIZIME QYTET
GJIROKASTER SH.A.**

Neni 1


Emërtimi dhe selia

1. Shoqëria aksionare ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të Bashkisë Gjirokaster, aksionarë të saj.
2. Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet "Ujësjiellës-Kanalizime Qytet Gjirokaster", SH.A.
3. Selia e shoqërisë është në adresën: Gjirokaster, Zona Industriale, Rruga "Muhedin Muço", godine 1 kateshe, Zona Kadastrale 8543, Nr.pasurie 20/12.

Neni 2

Objekti

1. Objekti i shoqërisë brenda territorit të Bashkisë së krijuar sipas ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", është:
 - a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
 - b) Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm;
 - c) Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
 - ç) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
 - d) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.
2. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
3. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi.



Neni 3

Kapitali

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 128.000.000 (njëqind e njetete e tete milion) lekë. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar tërësisht.
2. Kontributet e aksionarit janë kontribute në natyrë, të cilat janë vlerësuar përpara regjistrimit të shoqërisë nga një ekspert i caktuar nga gjykata kompetente, vlerësim i cili është materializuar në një raport vlerësimi që përmban një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë.

Neni 4

Aksionet e shoqërisë

1. Aksionet janë të formës nominative dhe pronësia mbi to është e patjetërsueshme, me përjashtim të rasteve kur e drejta e pronësisë i kalon një organi të qeverisjes vendore.
2. Pronësia mbi aksionet, rezulton nga regjistrimi i tyre, në emër të titullarit në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë.
3. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga një kuotë me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë dhe zotërohet në masën 100% nga aksionari.

Neni 5


Organet e shoqërisë

1. Organet e shoqërisë së ujësjellës-kanalizime sh.a., janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme;
 - b) Këshilli i Administrimit.

Neni 6

Asambleja e Përgjithshme (AP)

1. Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrer, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".



2. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në selinë e shoqërisë. Ajo thirret nga Kryetari i AP-së, Këshilli i Administrimit, Administratori i shoqërisë. Ajo mund të thirret, gjithashtu, nga:

a) eksperti kontabël i autorizuar;

b) nga një mandatarbajtës, i caktuar nga gjykata, me kërkesën e çdo personi të autorizuar për një rast urgjent;

c) me kërkesë të aksionarit të vetëm të shoqërisë.

3. Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.

4. Thirrja e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhet nëpërmjet lajmërimit që botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore dhe që i dërgohet me anë të një njoftimi me letër rekomande çdo anëtar të Asamblesë së Përgjithshme me shpenzimet e shoqërisë.

5. Në njoftimin, që duhet t'i shkojë çdo anëtar të Asamblesë së Përgjithshme apo të njihet prej çdo anëtar, të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së saj, përcaktohen dita, ora dhe vendi ku bëhet mbledhja, natyra e mbledhjes dhe rendi i ditës.

6. Çdo vendim i marrë nga Asambleja e Përgjithshme që thirret në mënyrë të parregullt është absolutisht i pavlefshëm. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas procedurës së kësaj dispozite, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë anëtarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht nga parregullsia.

Neni 7


Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:

a) Përcakton politikat tregtare të shoqërisë, si dhe miraton planin e biznesit të hartuar nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë, i cili duhet të përputhet me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë e kanalizimeve dhe treguesit të punës, për të cilët është rënë dakord midis palëve kontraktore;

b) Miraton pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;

c) Miraton projektplanin tarifor që propozohet për miratim në Entin Rregullator të Ujit;



ç) Emëron dhe shkarkon ekspertët kontabël të autorizuar;

d) Vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

dh) Çdo kompetencë tjetër që parashikohet të ushtrojë Asambleja e Përgjithshme në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe në statut.

2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit të Administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Neni 8

Kryetari dhe sekretari i Asamblesë së Përgjithshme

1. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrer, i cili është edhe Kryetari i AP-se.

2. Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme asistohet nga një sekretar i emëruar nga AP-ja, i cili është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, si dhe për detyrat e tjera asistuese që i ngarkon Kryetari i AP-së.


3. Në procesverbalin e çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e AP-së, jepen data dhe vendi i mbledhjes, mënyra e thirrjes, rendi i ditës, emrat e drejtuesit e të sekretarit të AP-së, kuorumi i arritur dhe numri i aksioneve me të cilat është votuar, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e AP-së, një përmbledhje e diskutimeve, teksti i vendimeve të kaluara për votim dhe rezultati i votimit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit e AP-së në mbledhje, si dhe nga sekretari.

Neni 9

Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme

1. Rendi i ditës i mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme përcaktohet nga personi i cili bën lajmërimin.

2. Në rast se mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme nuk realizohet, rendi i ditës i mbledhjes së saj nuk mund të ndryshohet në lajmërimin për mbledhjen e dytë.



Neni 10

Kuorumi dhe marrja e vendimeve

1. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme, ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
- ç) Investimet;
- d) Riorganizimin e shoqërisë.

Neni 11

Këshilli i Administrimit (KA)

1. Këshilli i Administrimit është organi i vetëm që ushtron funksione administrimi dhe mbikëqyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë.

2. Kohëzgjatja e funksionit të Këshillit të Administrimit është 3 vjet. Mandati i KA-së ndërpritet në rast konstatimi të mospërmbylljes së objektivave të vendosur në kontratën e performancës midis AP-së dhe anëtarëve të KA-së, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Nëse një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit të Administrimit mbeten vakant, për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e mbetjes vakant të vendit. Anëtari i Këshillit të Administrimit i emëruar në zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit.

4. Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 1 (një) Këshill Administrimi të shoqërive aksionare që e kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Këshilli i Administrimit zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata ushtrojnë këtë funksion për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm.



Këshilli i Administrimit mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton atij dhe pagën, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Në rast mungese të Kryetarit, mbledhjet e Këshillit të Administrimit drejtohen nga Zëvendëskryetari.

Neni 12

Përbërja e Këshillit të Administrimit

1. Anëtarët e Këshillit Administrimit janë persona fizikë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat 3-vjeçar dhe mund të rizgjidhen. Ata duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jenë me profesion inxhinierë të fushës, ekonomist ose jurist.

- Të kenë të paktën eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këtë nen është absolutisht i pavlefshëm.

2. Këshilli Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, 1 (një) prej të cilëve është administratori dhe 2 (dy) janë persona të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri.

3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit, në momentin e emërimit, lidhin me shoqërinë një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar, ndër të tjera, kriteret e qarta performance që pritet të arrijë anëtari i Këshillit të Administrimit në terma vjetorë. Objektivat për performancën të vendosura në këtë kontratë, duhet të miratohen edhe nga Ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me biznesplanet e shoqërisë.

4. Në rastin e vendeve vakante, që krijohen me vdekjen apo dorëheqjen e një apo disa anëtarëve të Këshillit të Administrimit, kur numri i anëtarëve të këtij këshilli ka zbritur nën minimumin ligjor, administratorët duhet të thërrasin urgjentisht mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për të plotësuar numrin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit.

Neni 13

Kompetencat e Këshillit të Administrimit


1. Këshilli i Administrimit ushtron, njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë dhe i jep administratorit autorizimin për kryerjen e veprimeve që nuk mund të kryhen prej tij pa autorizimin e Këshillit të Administrimit.



2. Këshilli i Administrimit ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

3. Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) Të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;
- c) Të gjykojë paraprakisht biznesplanin e shoqërisë, të paraqitur nga administratori. Ky dokument duhet të miratohet e të nënshkruhet nga të gjithë e anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- ç) Të përgatitë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- d) Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- dh) Të respektojë standardet e kontabilitetit;
- e) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- ë) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecursisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit të Administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- f) Të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'iu vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit të Administrimit. Raporti i Këshillit të Administrimit, përmendur në shkronjën "ë" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
- g) Të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 (pese) për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të çertifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;



gj) Të miratojë paraprakisht biznesplanin e paraqitur nga administratori dhe t'ia paraqesë për miratim përfundimtar Asamblesë së Përgjithshme.

4. Këshilli i Administrimit ka të drejtë t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme:

a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë;

b) Treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, si element bazë i vlerësimit të punës së administratorëve të shoqërisë;

c) Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;

ç) Marrjen e huave afatmesme e afatgjata;

d) Për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe që është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 14

Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i Administrimit mbledhet jo më pak se një herë në muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e Kryetarit.

2. Kryetari duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit të Administrimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur administratori ose 2 (dy) prej anëtarëve të Këshillit të Administrimit, i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.

3. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkues mund të thërrasin Këshillin e Administrimit duke i përcaktuar rendin e ditës.

4. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë ose në rrugë elektronike.

5. Çdo thirrje për mbledhjen e Këshillit të Administrimit duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës. Mbledhja e Këshillit të Administrimit zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrjen e bërë për këtë qëllim.



6. Këshilli i Administrimit mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në atë mbledhje.

7. Vendimet e Këshillit të Administrimit pasqyrohen në procesverbalet e mbajtura gjatë

mbledhjes nga sekretari i Këshillit të Administrimit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Vendimet e Këshillit të Administrimit duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Kopjet e këtyre procesverbaleve vërtetohen nga Kryetari dhe sekretari.

Neni 15

Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë KA-në ose një anëtar të saj, duke vërtetuar mospërbushjen e objektivave të vendosur në kontratën midis palëve, me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 16

Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit përfundon në rastet e mëposhtme:

a) Me mbarimin e mandatit të administratorit.


b) Me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tyre.

Neni 17

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

1. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme, sipas dispozitave përkatëse ligjore apo nënligjore dhe mbulohet nga shoqëria.

2. Shoqëria njeh gjithashtu edhe shpenzimet e bëra nga anëtarë të Këshillit të Administrimit, kur këta të fundit dërgohen me shërbim nga vetë Këshilli i Administrimit për probleme të shoqërisë.



Neni 18

Administratori i shoqërisë

1. Administratori i shoqërisë është person fizik, i cili zgjidhet si i tillë për shkak të funksionit në shoqëri, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Ai kryen administrimin e përditshëm të shoqërisë. Për t'u zgjedhur administrator, personi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master Shkencor", në shkencat inxhinierike, ekonomike, juridike apo në fushën e administrimit të biznesit, sipas profilit që do të emërohet.

b) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve e të trajtimit të ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij, nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe i certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizime, subjekti të paraqesë vërtetim nga Ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.

c) Të ketë eksperiencë pune si drejtues apo administrator në sektorin publik apo privat, si dhe rezultate pozitive të punës, të vërtetuar me referenca nga punëdhënësit e mëparshëm.

3. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me dispozitën e mësipërme është absolutisht i pavlefshëm.

4. Një person nuk mund të emërohet administrator në më shumë se një shoqëri.


5. Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetësh, por në bazë kontratash të rinovueshme vjetore. Rinovimi i kontratave midis Asamblesë dhe administratorit do të jetë vjetor në bazë vlerësimesh pozitive të performancës së punës. Numri i mandateve është i pakufizuar.

6. Paga e administratorit caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në aktin e emërimit të tij. Asambleja e Përgjithshme propozon shtim të pagës apo shpërblime për administratorin sipas kriterëve të performancës në kontratën e punës së lidhur ndërmjet tij dhe administratorit.

7. Administratori Ekzekutiv ka këto kompetenca:



- a) Menaxhon dhe është përgjegjës për aktivitetin e shoqërisë nëpërmjet zbatimit të politikave e të planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
- b) Harton planbizneset e shoqërisë dhe i paraqet në Këshillin Administrimit.
- c) Harton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë e cila miratohet nga Këshilli i Administrimit. Struktura e organizimit të shoqërisë duhet të ketë patjetër një Drejtor Teknike dhe një Drejtor Tregtare, drejtuesit e të cilave zgjidhen nga administrator sipas neneve 19 dhe 20, të këtij statuti.
- ç) I paraqet Këshillit të Administrimit një raport një herë në muaj për ecurinë e shoqërisë. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, administratori duhet t'i paraqesë Këshillit të Administrimit llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.
- d) Përfaqëson dhe vepron në emër të shoqërisë në marrëdhëniet me palë të treta dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së saj.
- dh) Paraqet çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme raportin e veprimtarisë së shoqërisë.
- e) Raporton përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
- ë) Lidh kontrata në emër të shoqërisë pas dhënies së mendimit edhe të dy drejtorëve të tjerë.
- f) Siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë vendas apo të huaj në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë.
- g) Nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshëm të detyrueshëm për menaxhimin administrativ e financiar të shoqërisë.
- gj) Organizon e bashkërendon punën ndërmjet sektorëve në përbërje funksionale të shoqërisë.
- h) Krijon një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë.
- i) Kryen regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe ligjeve të tjera në fuqi.



j) I paraqet propozime dhe sugjerime Këshillit të Administrimit në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet.

k) Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Administrimit.

l) Drejton veprimtarinë e shoqërisë, zgjedh dhe mbikëqyr personelin e saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Administrimit.

Neni 19

Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e Drejtorit Teknik

1. Drejtori Teknik zgjidhet nga administratori sipas kriterëve minimale:

- a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master Shkencor", në shkencat inxhinierike, në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme;
- b) Të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet.

Në rastet kur operatori ushtron veprimtari për përpunimin e ujërave për konsum publik apo për përpunimin e ujërave të ndotura, duhet të ketë edhe një drejtues të dytë teknik, të kualifikuar me diplomë universitare në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme.

c) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga Ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.

2. Drejtori teknik ka këto kompetenca:

- a) Bën studimin dhe hartimin e projekteve të nevojshme për furnizimin me ujë të konsumatorëve të veçantë ose zonave të banuara.



- b) Bën përditësimin e rrjetit të furnizimit me ujë e të kanalizimeve të ujërave të ndotura.
- c) Është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kontrollin e rrjetit shpërndarës.
- ç) Administron dhe mirëmban gjithë rrjetin e tubacioneve, kolektorët kryesorë, pusetat e shkarkimit të ujërave të ndotura dhe pajisjet që shërbejnë për largimin e ujërave të ndotura që vijnë kryesisht nga banesat (ujëra të ndotura dhe industriale).
- d) Është përgjegjës për sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve në fuqi dhe garantimin e një sistemi teknikisht të përshtatshëm për furnizimin me ujë që nga burimet deri te konsumatori.
- dh) Garanton largimin efikas të ujërave të ndotura me anë të një sistemi të përshtatshëm të rrjetit të kanalizimeve dhe trajtimin e tij në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.
- e) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës se lidhur me Administratorin.

Neni 20

Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e Drejtorit Tregtar

1. Drejtori Tregtar zgjidhet nga administrator sipas kriterëve minimale:

a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master

Shkencor", në shkencat ekonomike, në degët financë/administrim biznesi.


b) Të zotërojë certifikata përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë.

2. Drejtori Tregtar ka këto kompetenca:

a) Siguron mbarëvajtjen dhe zbatimin e procedurave ligjore për të gjithë veprimtarinë ekonomike-financiare të shoqërisë.

b) Siguron zbatimin e praktikave e të procedurave ligjore dhe nënligjore të cilat mbrojnë asetet e shoqërisë dhe administron burimet financiare të saj.

c) Harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv.



ç) Është përgjegjës dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si dhe raportin e administrimit, dokumente të cilat i'a paraqet për miratim paraprak administratorit ekzekutiv. Administratori ekzekutiv i paraqet Këshillit të Administrimit për miratim të gjitha pasqyrat financiare vjetore, raportin e administrimit, si dhe propozimet për caktimin e fitimit.

d) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.

dh) Ushtron kontrolle periodike mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të ndjekur nga specialistët përkatës.

e) Garanton ruajtjen e standardeve të kontrollit të brendshëm financiar dhe zbatimin e standardeve të kontrollit financiar të specifikuara nga Ministria e Financave.

ë) Siguron zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë.

f) Siguron zbatimin e sistemit financiar dhe të faturim/ arkëtimit të shoqërisë.

g) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës se lidhur me Administratorin.

Neni 21

Detyrimi i besnikërisë

1. Përveç sa parashikohet në dispozitat e këtij statuti, administratorët detyrohen:

a) Të kryejë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë;

b) Të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;

c) Të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim;

ç) Të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personale me ato të shoqërisë;

d) Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesio-nalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është



kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.

3. Administratorët, që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2, të këtij neni, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Neni 22

Shkarkimi i administratorit

1. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin me shumicë të thjeshtë votash në rast të konstatimit të mospërbushjes së objektivave të kontratës midis palëve.

2. Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë shkarkimin e administratorit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga një institucion shtetëror për shkarkimin e tij, si rezultat i një detyrimi ligjor/zyrtar.

Neni 23

Përfundimi i mandatit të administratorit

Mandati i administratorit të shoqërisë përfundon me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tij.

Neni 24

Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Neni 25

Ushtrimi kontabël

Ushtrimi kontabël fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.



Neni 26

Inventari - llogaritë vjetore

1. Mbajtja e kontabilitetit dhe paraqitja e pasqyrave financiare vjetore bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.
2. Në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, shoqëria i harton pasqyrat financiare vjetore në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar.
3. Administratori përgatit, në datën e pasqyrave financiare, raportin e administrimit për gjendjen dhe performancën e shoqërisë gjatë ushtrimit kontabël.

Neni 27

Rezultati i ushtrimit dhe përcaktimi i fitimit


1. Fitimi i tatueshëm përcaktohet sipas dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.
2. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 (pese) për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
3. Fitimet e akumuluar nga shoqëria, pas arritjes së rezervës 10 për qind, vlera e të cilave e kalon nevojën për investime dhe zhvillimin e shoqërisë, do t'i kalojnë dhe do të përdoren nga Bashkia. Fitimet e akumuluar brenda këtij kufiri do të përdoren nga shoqëria sipas nevojave të saj për investime kapitale.

Neni 28

Procedura e bashkimit të shoqërisë me operatorë të tjerë

Shoqëria aksionare mund të bashkohet me operatorë të tjerë vetëm në rastet kur nga ana e shoqërive të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) Të jetë të licencuar nga Enti Rregullator i Ujit.



- b) Të ketë vlerësuar dhe përditësuar inventarin e asetëve e të likuiditeteve të tyre.
- c) Të jetë miratuar me vendim përkatës të Këshillit Bashkiak.

Neni 29

Likuidimi i shoqërisë

Likuidimi i shoqërisë të bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

Neni 30

Dispozita të kalimtare

Për sa nuk është parashikuar në statut, rregullimi i modaliteteve të tjera që lidhen me funksionimin e shoqërisë, të bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve me datë 07/04/2016.

at.

Handwritten signature